



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor-Ministarstvo Sredine i Prostornog  
Planiranja-Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/ Kancelarija Generalnog Sekretara /Office of Generaly Secretary

DATË/A:	07/11/2018
REFERENC-Ë:	ZSP - 1485/2018
PËR/ZA/TO:	Komuna Klinë
CC:	
NGA/OD/FROM:	Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm i MMPH-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Shqyrtimi i kërkesës nga Komuna e Klinës për Taksat për Leje Ndërtimore me Nr. Protokolli 6377/18 të datës 05.11.2018

Të nderuar,

Bazuar në shkresën e datës 05.11.2018 me numër protokolli 6377/18, lidhur me caktimin e taksës administrative për leje ndërtimore, taksës administrative për leje rrënimi dhe tarifës për rritjen e densitet të infrastrukturës nga Komuna e Klinës (tutje si: Komuna), MMPH ka shqyrtuar dhe analizuar shkresën se bashku me dokumentacionin përcjellës dhe konstaton si në vijim:

Komuna ka propozuar Taksat në pajtim me Ligjin për Ndërtim Nr. 04/L-110 dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2018 për taksat administrative për leje ndërtimore, leje rrënimi dhe tarifafat për rregullimin e infrastrukturës.

Taksa Administrative për leje ndërtimore për kategorinë e I-rë e llogaritur nga Komuna është **2.10 €/m<sup>2</sup>** (dy euro e dhjetë centë për metër katror).

Taksa Administrative për leje ndërtimore për kategorinë e II-të e llogaritur nga Komuna është **2.70 €/m<sup>2</sup>** (dy euro e shtatëdhjetë centë për metër katror).

Taksa Administrative për leje rrënimi e llogaritur nga Komuna është **0.60 €/m<sup>2</sup>** (zero euro e gjashtëdhjetë centë për metër katror).

Tarifa për rritjen e densitetit të infrastrukturës është llogaritur konform Shtojcës 7 të UA Nr.02/2018 dhe kjo Tarifë duhet të llogaritet vetëm për njësit e reja të banimit.

Komuna duhet të procedoj për aprovim taksat në pajtim me procedurat e parapara me Ligjin për Ndërtim Nr. 04/L-110.

Me respekt,

Faqe 1 nga 1